



Republikë e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel:038/20043814

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY
ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 27-të e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 22.05.2020 (e Premte), në sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 14. Eliot Kukiqi, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 15. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 3. Besa Ferati, LDK; | 16. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 4. Naim Behlulaj, LDK; | 17. Labinot Aliaj, PDK; |
| 5. Njomza Demaj, LDK; | 18. Arben Kabashi, PDK; |
| 6. Haki Podrimaj, LDK; | 19. Ajshe Metaj, PDK; |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK; | 20. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 8. Riza Dreshaj, LDK; | 21. Agron Avdijaj, VV; |
| 9. Valbona Demaj, LDK; | 22. Lavdije Bujupaj, VV; |
| 10. Edona Lubeniqi, LDK; | 23. Arif Elshani, IQ; |
| 11. Naim Imeraj, AAK; | 24. Radoš Repanović, SLë |
| 12. Nexhmedin Balaj, AAK; | 25. Radenko Belošević, RB dhe |
| 13. Misin Berisha, AAK; | 26. Slaviša Maliković, SM. |

Mbledhja ishte e hapur dhe në të ishin të pranishëm edhe Kryetari Haki Rugova, drejtorë të drejtorive të komunës, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj, (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe në CD-të e xhirimit, të cilat gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj. Kryesuesi përshëndeti të pranishmit, hapi punimet për mbledhjen e 27-të të rregullt, të Legjislacionit të VI-të dhe për këtë mbledhje propozoi rendin e ditës.

Rendi i ditës

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Njoftimi me gjendjen aktuale në Istog gjatë periudhës kohore të Pandemisë të shkaktuar nga Virusi - Covid19,
3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit financiar për vitin 2019,
5. Shqyrtimi i Raportit Financiar për tre mujorin e parë të vitit 2020,
6. Marrja e vendimit për Bartjen e mjeteve financiare nga vitet 2018,2019 nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara në vitin 2020,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Nismes së Kryetare të Komunës për bashkëpunimit nderkomunal me komunë e Pejës ,
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Arben Kabashi – përshëndet të gjithë të pranishmit, si anëtar i planit të punës së Kuvendit për vitin 2020 i kemi pasur të planifikuar për muajin marse dy pika në rend dite , shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve nga ekzekutivi po ashtu për muajin majë i kemi pasur dy pika shpallja në diskutim për themelimin e tregjeve dhe Shpallja në diskutim publik e projekt Rregullores për Këshillat e fshatrave. Mos ta injorojmë të gjithë planin e punës së KK, edhe nëse shtyhen bile të sqarojmë.

Kryesuesi – lidhur me atë që tha Arbeni, e vërtet që kemi planin e punës por për shkak të mos mbajtjes së këtyre dy takimeve ati do të shtyhen për një periudhë. Pyet anëtarët e Kuvendit nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës, pasi që askush nuk u lajmëruar, hedh në miratim rendit e ditës:

Kuvendi unanim miratoi rendin e ditës për këtë mbledhje

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi, njoftoi se në mbledhje mungon një anëtar i Kuvendit ndërsa 26 anëtar janë prezentë në mbledhje.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi, vazhdon me pikën e dytë të rendit të ditës, Njoftimi me gjendjen aktuale në Istog gjatë periudhës kohore të Pandemisë të shkaktuar nga Virusi - Covid19,. A ka dikush diçka lidhur me këtë procesverbal? Labinot Aliaj ka kërkuar fjalën.

Kryetari i Komunës - përshëndet të gjithë të pranishmit, mirë që filluan seancat e rregullta të Kuvendit të Komunës, kemi edhe vendimin e qeveris se mund të vazhdojmë me seanca të rregullta të KK.

Fjalën ia kaloj drejtorit të shëndetësisë, Mujë Osmanaj, ka qenë faktori kyç në këtë pandemi, dua të i falënderoj të gjithë që kanë dhënë kontributin e tyre, Policin, QKMF-në, drejtoret e drejtoreve, sidomos qytetaret për një përkushtim të madh për menaxhimin e pandemisë mendoj që ja kemi dal me këtë betejë deri me sot nuk kemi rezultate të këqija, i kemi disa që nuk dua ti diskutojmë njëherë deri sa të përfundoj në tersi situatën, do ta lus edhe Mujën të ju njoftoj me gjendjen aktuale momentale. Ne në fillim e kemi bër një shtab në bazë të instruksionit nga Ministria e shëndetësisë që na ka ardhur por ne ndërkohë e kemi zgjeruar edhe shtabin ku kanë qen edhe katër të tjerë nga të gjitha instancat e duhura natyrisht që Kuvendi Komunal pos Qaushit që ka qenë aktiv gjithë kohën disa nga ju ndërsa të tjerët nuk kanë mundur sepse ekzekutivi e ka pasur obligim, stafi ka punuar në mënyra të vazhdueshme deri në ora 12 disa edhe ter ditën por disa me vendime kanë shkuar në pushime sidomos ata të cilët kanë pas fëmijë të vegjël etj etj. Ja kemi dal të i kryejmë punët tjera jo vetëm rreth pandemisë por me disa pengesa. mendoj që kjo periudhë po vazhdon edhe tash rast i mirë që diskutojmë një rast i mirë është edhe kjo Ridestini apo shpërndarja e mjeteve të bartura raporti financiar që do të thotë po hymë në bazën e normalitetit në kuptimin e funksionimit. Edë qe jemi vënuar por besoj që do të ja dalim nga 1 qershori do të fillojmë me punë me staf të plot, edhe pse stafi i domosdoshëm i nevojshëm është jo vetëm de jure 11 por është pas dite, po ju them të drejtën se një numër jo bash i vogël i stafit komunal drejtoreve të drejtoreve kanë qene jo vetëm ditëve të punë por edhe të shtënëve e të djeleve kanë qenë gjithmonë në për komunë edhe në teren. Ia kalon fjalën drejtorit të Shëndetësisë Mujë Osmanaj.

Mujë Osmanaj, Drejtor i Shëndetësisë - përshëndet të gjithë të pranishmit, dhe njofton për gjendjen aktuale me Covid 19.

Kryetari i Komunës - nuk deshta qëllimesh të hy në disa gjëra si hyri Muja nuk dua ti diskutojmë raportet të niveleve Qendrore të institucioneve të ndryshme që merren me pandeminë ato janë tema që diskutohen herëve tjera, si kryetar Komune kam qenë në komunikim të vazhdueshëm qoftë me telefona qoftë me shkresa me kryeministrin Kurti, me ministrin Vitia, me institutin Qendror z. Ramadani ato janë vendosur në baza shumë të qarta, dyshimeve të ndryshme që kanë dal nëpër diagnoza ato kanë qenë tema të cilat unë nuk kam ndërmend ti hap për një arsye se nuk po e ndie veten as kompetent dhe as që ish dashtë të merrem me ta në fund të fundit Ligjet merren me këtë punë që sigurisht që kanë me u merr ose janë duke u marr kjo është temë tjetër por mendoj që ja kemi dal. Edhe një herë po e përsëris vërtete edë që ka pas shkelje të qytetarëve mirë po kam pasur sjellje edhe të Policisë, policia në teren kanë pasur vërtet sjellje korrekte, kanë qenë në nivel QKMF-ja ka qen në nivel, Policia ka qenë në nivel institucionet tjera kanë qenë në nivel dhe jemi këtu ku jemi. Kuvendi ka nevojë të informohet me shumë sidomos rreth këtyre

pakove ushqimore higjienike e përkrahjeve që kanë ardhë financiarë dhe materiale nga donatorët e ndryshëm, të cilat janë krejt transparente, ne do t'i qesim në ueb-faqe por do ta sjellim komplet në seancën e ardhshme, Drejtori Enveri një raport se do ta shihni çdo cent ku ka shku ne kemi marrë vendime si Kryetar Komune kam marr vendime dhe mjete që i kom nda në kuadër të kompetencave që i kam për përkrahje me pako ushqimore e higjienike nga mallrat dhe shërbimet, aj vendim është marr dihet ku janë marr me kode, edhe aj vendim është marrë në bazë të Ligjit mbi menaxhimin e financave nuk ka pasur ndonjë gjë por emrat e përfituesve ndonjëherë nuk janë fort popullatës, ju e patë edhe vet doktorin as një emër te të infektuarve nuk e ka përmendur edhe pse i dimi, edhe ju besoj që i dini por nuk përmenden ato për shkak se njerëzit po e marrin infeksionin si një lloj mëkati, kjo s'është mëkat është sëmundje. Kështu që çdo gjë do te jete publike në ueb- faqe të komunës, edhe këtu para jush me dokumente me të gjitha në mënyra që mos te kemi telashe të merremi me këto tema në një të ardhme kjo është ajo tema në një periudhë financiare periodike ato kanë qenë si shënime.

Zenel Shatri - përshëndet të gjithë të pranishmit, pasi që është aktuale pandemia nuk është e tepërt me fol aktuale është në të gjithë botën jo veten tek ne, dhe në për hire të kësaj nuk kemi mundur me mbajt as mbledhje deri tani. Dua të jap ndonjë rekomandim dhe në aspektin profesional, shtabi që u formu pranë komunës, unë pasi që jam në Pejë atje dhe jam anëtar i shtabit, kryetari çdoherë është kryetar i shtabit, mendoj që ky shtab e ka kryer punën me përkushtim shumë të madh shumë mirë e përgëzoi për punën e shtabit duke filluar nga kryetari nga drejtori i drejtoratit për shëndetësi njëherit një falënderim i veçantë për të gjithëpunonjësit e policis punonjësit e tjerë që kanë kryer shërbime publike higjienike, njëherit edhe popullatës që ka qen e mirë, zakonisht popullata e Istogut shquhet për sjellje mirësjellje unë krenohem çdo here me popullatën ton sepse jem të dëgjueshëm jemi mjaft ekspeditiv. Për detalizime nuk deshtëm të hymë shumë por deshta pse jemi ende në epidemi tash numri ka ra kryesisht kur bjen në 5% numri brenda dite atëherë llogaritet që është ra. Mirë po megjithatë ende nuk duhet të shlirohemi ky është një apel për shtëpinë e shëndetit për arsye se ende duhet të kemi kujdes kryesisht të punëtorët që punojn në shtëpinë e shëndetit ata duhet të ken mjete mbrojtëse në punë dhe duhet respektuar mjetet mbrojtëse, kryesisht maska është e domosdoshme në punë dhe kryesisht ku punohet këta mjektet duhet të perdorin doreza, dorezat janë një përdorimesh. Apeloj që mjetet mbrojtëse të përdoren mile të stafi mjekësorë sepse aty merren shembuj të tjerët.

Agron Avdijaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, e kisha filluar me atë që pandemia është menagjuar mirë edhe në Istog, i përgëzoi të gjithë ata që kanë qenë të angazhuar në këtë proces duke filluar nga shtabi e të gjithë akterët tjerë pa hy rendë falënderimet një nga një po në anën tjetër duhet ta kemi një far krahasimi në raport edhe me komunat tjera kurë është qështja edhe të seancat ne e kemi biseduar edhe me kryesuesin pak ndoshta situata në Istog ka qenë me e qetë dhe është vlersu që mos me u mbajt seanca ka komuna tjera që kanë mbajtur seanca tjera kanë

gjet forcën dhe e kanë mbajtur po ashtu edhe fondi për ndarjen e përkrahjes shumë komuna edhe me të vogla se Istogu kanë nda vlera më të mëdha nuk e di ndoshta ka qenë e parapamë kaq sepse është menduar në fazën tjetër nëse paraqitet nevoja të ndahet. Në anën tjetër unë e pashë pavarësisht problemeve që kemi pasur me nivelin qendrorë këto vendimet ligjore dhe jo ligjore Komuna e Istogut është paraqitur mirë në respektimin e tyre pavarësisht dilemat duhet me i trajtu dikush tjetër mirë po në anën tjetër mendoj që është dashur me u dhënë edhe një falënderim i ministres së Shëndetësisë sepse prej drejtorit nuk u përmend shumë ministria e shëndetësisë me shumë u pa si problem, di që ka pasur diçka me na in formu. Përveç kësaj ndoshta në raport është dashur mirë me i përfshi, pak a shumë i dimë por sa raste janë testuar sa janë pozitiv shumë shkurt pa hy në detaje të rasteve me i përshkru rastet por pa dhënë statistika. Edhe të qeshja e përkrahjeve me dit sa janë përkrahe deri tani, a janë përkrah të gjithë në listën sociale sa jashtë asaj liste me i dit si informata.

Kryetari i Komunës - e thash edhe në fillim kuptimin e mbajtjes së seancave disa komuna kanë mbajtur seanca të jashtëzakonshme edhe në kushte edhe me të renda se qare jemi tani të distancimit fizik e ku ta di unë ato procedura kanë mbajtur për shkak se kanë nda mjete edhe me shumë se na por kanë nda nga format tjera të ndarjes buxhetore si dhe nuk kanë mundur ta bëjnë pa Kuvend, kjo ka qenë ne kemi shkuar me mallra dhe shërbime ku me ligje kjo na lejohet, i kemi nda diku 50 mijë euro për gjera ushqimore dhe higjienike, hiqe këto përkrahjet nga donator e ndryshëm. Dhe besoj që i kemi përmbush disa nevoja të qytetarëve dhe nuk besoj që është hargju as gjysma deri tani. Po ne e kemi planifikuar që atë pjesë ta hargjojmë deri në fund të vitit se për përkrahje do të ketë nevojë ende. Dhe unë as një ankesë nuk e kam pasur të gjithë kanë thënë se kanë qen të kënaqur me ndarjen, ndarja ka qenë më shumë e drejtuar nga komuniteti egjiptian minoritetet të cilët janë në një gjendje me të rend. Nuk janë përfshirë rastet sociale gjithmonë, me vendim të qeveris rasteve sociale për dy muaj ju ndanë nga 130 euro, kjo ka qenë një ndihmë e madhe për ta dhe kjo ka qenë me i shti edhe ata në listë kemi punuar shumë me kryqin e kuqë me listat e tyre, listat i kemi marr nga Qendra për punë sociale, kemi punuar me të gjitha këto instanca. Kemi pasur edhe nga komuniteti serbë lista, nga komuniteti boshnjak, të gjithë janë të përfshirë se aj është buxhet komunal. Ndërsa donatore kemi raste kur na kanë dhënë në besim që ne ti shpërndajmë, por ka raste që kanë shpërnda vet kanë kërkuar lista prej nesh. Nuk ka këtu ndonjë problem me Ministrin e shëndetësisë këtu, e thashë kemi pasur komunikim jashtëzakonisht korrektë me ministrin Vitia, se aj edhe ashtu shquhet për korrektësi e kam pas shumë të qartë ata bile bile po e zbuloj një detaj, me ka thënë as një here nuk e shpall as gjendja karantine as një formë tjetër pa pëlqimin tënd. Ndonjëherë me Institutin kemi pasur disa fërkime që unë nuk kam pranuar në mënyre të pa nevojshme me e shpall një zonë karantine, ka qenë me e shti në karantinë krejt fshatin Lluga ose fshatin Studenicë ose krejt komunën, me tri raste donin krejt komunën me e shti në karantinë jo nuk kam pranuar, ndoshta kom lutje me kartën e rrezikut por e kam marrë përgjegjësin së qe i kam pasur edhe unë dyshimet e mia

rreth këtyre karantinave. Mirë po Policia edhe ashtu ka pas urdhër ti vizitoj kohë pas kohe bashke me QKMF-në mirë po ne kemi evituar prezencën e policisë 24 orëshe ky ka qenë angazhim i përbashkët kështu që ka funksionuar kjo.

Labinot Alijaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, falënderon QKMF-në , Policinë, zjarrfikëset, të gjithë ata që u angazhuan këto ditë, unë gjatë këtyre ditëve përveç që kam qen shumë aktiv i kamë parë edhe këto dy anët e menaxhimit pozitiv dhe negativ, është për tu përshëndetur puna e stafit të shtabit emergjent të komunës, mirë po kam vërejtje në mos rritjen e numrit të shtabit që ka mundur të jetë edhe një përfaqësues i shoqërisë civile edhe i bashkësive fetare të cilët e dimi që ka qenë e detyrueshme që të ndërhy policia në varrime të disa raste për këtë arsye do të ishte shumë e mirë që të ishte dikush nga shoqëria civile dhe nga bashkësia fetare pjesë e shtabit, mirë po kjo është paraparë nga ju dhe kjo varet nga ju se për kë vendosni kush mund të jetë dhe kush jo pjesë e shtabit ndërsa vërejtjen me të madhe e kam të ju kryesues sepse nuk e ke marr guximin ose me na e dergu të paktën vetëm një imell me na sqaru arsyen e mos thirrjes së mbledhjes edhe pse ne e kemi ditur, ka qenë e natyrës edhe të paktën shëndet me na deshuru se jemi pjesë e stafit tënd, por nuk na ka ardhur as ajo imell kështu që gjendja po dihet siç është po presim pasi që tha Kryetari do ta kemi edhe një raportim nga drejtori i Shërbimeve Publike lidhur me pakot e dhuruara dhe ndihmat që janë dhënë . Faleminderit për të gjithë që janë angazhuar këto ditë, faleminderit shumë ty Kryetar dhe të gjithë drejtorëve, shpresoj që bashke do ta vazhdojmë kështu edhe nuk do të kemi më përsëritje të rasteve.

Arben Kabashi - në emër të grupit parlamentar të PDK- së dua ta falënderoj Kryetarin, drejtoret. Të gjitha masën për këtë pandemi që e ka prekur pak edhe komunën e Istogut në kuptimin që unë personalisht mendoj është një grip i zakonshëm ndoshta me i lehtë se ajo që ka qenë përpara po flas personalisht. pyet Kryetarin, a janë deleguar kompetencat nga Qeveria Komunave pasi që i kemi par vendimet anti kushtetuese nga ana e qeveris dhe kryeministrit në detyrë që një far formë nuk ka ditë ta menaxhoj edhe kjo e ka prekur direkt edhe qytetarin e komunës së Istogut për një arsye, sepse kanë pasu pasojat në ekonomi të dënimeve që janë marr qoftë të lëvizja e qytetarëve që ka qenë anti kushtetuese kjo pra e ka prekur edhe qytetarin e Istogut . Nuk e kemi numrin e skat të dënimeve që janë marrë prej qytetarëve që janë dënuar nga Policia në rrugë, biznese e kso me radhë po thjeshtë ato vendime anti kushtetuese e kanë prekur edhe qytetarin e Istogut. Atëherë nëse janë deleguar kompetencat a kemi përfundim që kryetaret kanë të drejt me marr një vendim për shpalljen e kësaj pandemie me përfundim me e dit deri kurë apo thjeshtë duhet me u nvar nga Qeveria që ta merr një vendim anti kushtetuese.

Kryetari i Komunës - Arben nuk e di a mundem apo a di me tu përgjigj, i kemi juristë le të më korrigjojnë, një gjë e di Vendimet antikushtetuese që i ka marr Qeveria nuk e lejon kryetarin e komunës mos me i zbatu ato vendime edhe pse janë anti kushtetuese nuk amnistohen prej asaj , gjykata Kushtetuese e ka prur e ka dhen afatin ky është dhe duhesh me i hjek ato ku di unë. Kam vepruar si Kryetar Komune

bashke me stafin në kuadër të vendimeve që i ka marr qeveria pavarësisht nga ajo që kushtetusia që i ka shpall antikushtetuese. Qështja e dënimeve që i kane bërë policia Inspektoret aj është një muhabet tjetër ata njerëz që mund të ankohen aty mund të thirrën edhe nëpër gjykata le të ankohen edhe le të vazhdon procedura kerkujt nuk mund ti them mos e paguaj i kom lutë në mënyre shoqërore Policin ju kom thëne këqyrni kapak ndërmjet gishtave, bile kjo liria e lëvizjes për mua është shumë e ndishme, sepse njerëzit kanë nevoja të ndryshme, ka pasur sukses kjo kemi pak raste të dënimevë.

Kompetencat e mia janë në bazë ligjore në bazë të ligjeve që janë në fuqi, kam pasur të drejtë ta bëje shtabin emergjent dhe e kamë bërë edhe shtabi ka punuar në bazë të instruksioneve edhe udhëzimeve që kane ardhur nga qeveria nga ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, ne strikt kemi punar në bazë të këtyre aq sa kemi mundur , nuk po e përjashtoj mundësin ndoshta kemi bërë edhe ne ndonjë shkelje që unë kam pasur vërejtje për shembull që unë dy javë përpara e kam marr një vendim me nënshkru bile kamë pas guximin me marr vendimin kam lejuat hapjen e tregut të gjelbert, jemi komuna e parë, dhe Vendimi ka qenë publik. Dhe kjo ka funksionuar shumë mirë.

Pastaj ka qenë Vendimi që kam marr si Kryetar Komuna kam vendosë dy shirita të burimi i Istogut sepse aty ka qenë një frekuencë e madhe e njerëzve që kam qenë e kam parë vetë, edhe kjo ka funksionuar mirë.

Kam qenë mjaft i pa kënaqur me pengesat ndalesat e tepruara të bizneseve, disa biznese nuk kanë pasur nevojë me u ndal hiq ose i kanë ndal gabimisht, janë leju prodhimi i betonit e o ndalu ndërtimi, ka qen një far mos koordinimi. Sidomos ajo që bujqit mi marr do letra në drejtorin e bujqësisë a është i regjistruar si fermer, ja ndal njerit me marr shatin e me dal mi ndrru specat p.sh.

Agron Avdiaj - unë për qita e bëra falënderimin në fillim pavarësisht këtyre problemeve në nivelin Qendror komuna i ka respektuar edhe realisht është e drejt me i respektu, a është i drejt vendimi a jo janë organet tjera që kane me u trajtuar në instanca tjera që mendoj nuk ish dashur me politizu këtu mirë po në anën tjetër edhe për qeverinë ka qen problem me ditë sakt si mi marrë masat se mendoj që tollovin me të madhe e kanë bërë ndonjëherë edhe badihavgjitë, ti nuk ke pasur qare pa e qit një rregull edhe më ditë që është fermer aj ka qenë problem me dal qytetari valla po shkoj me prashit e se ka pas qëllimin me prashit, janë pjesë e diskutimeve ndoshta në nivelet tjera që nuk kisha dashtë me hy kësajde.

Naim Imeraj – përshëndet të gjithë të pranishmit, e mora fjalën për dy çështje një së pari mos ta trajtojmë këtë pikë të rendit të ditës si vlerësim po është një njoftim kemi kohë ne me vlerësuar bollë ta kalojmë këtë fazë pastaj të vlerësojmë nga të gjitha dimensionet po besoj se edhe situata politike do të jetë me e qartë dhe nuk do të kemi më me këso vlerësime anësore se nuk po them që nuk janë ndikuese përcaktuese ajo çka du me thëne personalisht , që u përsërit është një mirënjohje e thellë për të gjithë akteretë pjesëmarrës në këtë trajtim të kësaj gjendje pandemie edhe për sukseseshmërin deri me sot të punës që po shihet nuk është element që

duhet të vetëkënaqemi edhe fillojmë të merremi që nuk ka qenë kurrëgjë kjo punë, bile bile i kisha lutë që se paku prej foltoreve publike mos të del dikush e të thotë "kërkoj falje nuk e kam me të keq" që një grip i thjeshtë, duhet me e provu së pari e me i kaluar 14 ditë e pastaj me u ul e me thënë ka qenë kështu apo ka qenë ashtu, vlerësimet tjera ju mbeten instancave profesionale, e ka me shkuar kohë e gjatë duke u marrë me këto që ende janë duke u marrë në mënyrë emergjente me situatën kështu që ju kisha lutur që publikisht të kemi kujdes sa mundemi me dhënë. Po i bashkëngjitëm doktor Zenelit në thirrjen që të jemi të kujdesshëm që neper maretë e neper, nuk e kemi me e trajtu që personalisht e kemi trajtu këtë fazë e prej një personi ja ka nis e jemi bërë njëmijë e sa, dhe prape mundet të jetë një i pa definuar me e rikthye situatën në disfavor të popullatës edhe një here një vlerësim i plotë dhe mirënjohje për punën e të gjithë akterëve që kanë qenë në këtë kohë në krye të detyrësi.

Arif Elshani - përshëndet të gjithë të pranishmit, pak Arbeni me shtini me fole, vendimet e gjykatës Kushtetuese ato janë vendime që i kanë vlerësuar a janë të ligjshme apo jo Kosova si shtete Qeveria jonë i ka pasur Vendimet me të lehta se sa shtetet tjera të rajonit, shumë shtete kanë pasur gjendjen e jashtëzakonshme, ku në nuk kemi pasur edhe ajo e ka dhen afatin që ka pasur. Unë kisha thënë se si komunë si anëtar të kuvendit, komuna ka kaluar mirë është përcaktuar mirë. Pavarësisht që demet në ekonomi i kemi të jashtëzakonshme nuk kemi ne nevojë të merremi me gjykatë aq sa po ma merr mendja se aty më së paku do me thënë veç qeveria Kurti po ka qenë edhe LDK-ja dhe të tjerët dhe mendoj që mirë e kanë menaxhuar, dhe nëse e kanë menaxhuar mirë ne duhet të shkojmë me tutje me pa çka masë sodit ne duhet të dimi një si komunë që ekonomia jonë është në një situatë të vështire ne kemi me paguar paga si ndërmarrës e kemi problem me i mbajte punëtooret, i kemi problemet që kanë me na përcjelle duke filluar nga shtëpia prej ndërmarrjes e të komuna edhe kjo është obligimi kryesor të merremi masë sodit si ti tejkalojmë këto vështirësi të mujshim me i tejkalua, të shikojmë se çka mundet komuna të rritë buxhete të lëshojë punë tu japë ndërmarrësve dhe të fillojmë në me një aktivitet pozitiv që ne kemi nevojë me u rimëkëmbe po mundet bota me u rimëkëmb jo Kosovë që jemi me pakë.

Mirushe Sadikaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, deshta vetëm dy fjali për pakot emergjente, të rastet sociale një anëtar nga komuniteti egjiptian që është anëtar i komunitetit për Komunitete është ankuar të ndarja e pakove emergjente nuk janë nda në mënyrë të duhur, ka pas raste që disa familje kanë marrë nga disa herë, ndihma e disa të tjera jo edhe ato që kanë pasur shumë nevojë. Kërkoj që në mbledhjen tjetër kurë të bëhet raporti të bëhet në mënyrë të detajuar të informohemi në hollsi.

Riza Dreshaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, dua të falënderoj Policin e Republikës së Kosovës, dhe të gjithë shtabin emergjentë, me gjithë këta dua ti falënderojë për punën e bërë deri me tani por edhe për policinë, Drejtoria e Policisë

në Istog, se me të vërtetë e kanë kryer një punë shumë perfektë e sidomos në fshatin Vrellë me rrethinë aty që ju e dini, se në Vrellë e kemi shprehi me dal në mbremje në qendër dhe bëhen disa guzhma aty pak me shumë se qendrat tjera, detyrën e kanë kryer shumë mirë. I falënderoj shumë.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka kalojmë në pikën tjetër.

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi, vazhdon me pikën e tretë të rendit të ditës, miratimin i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A ka dikush diçka lidhur me këtë procesverbal?

Kuvendi në mënyrë unanime miratoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi, vazhdon me pikën e katërt të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit financiar për vitin 2019, fjalën ja kaloi z. Osmaon Sadikaj.

Osmaon Sadikaj, ZKF – përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezentin dhe sqarimin e Raportit financiar për vitin 2019.

Naim Imeraj – atë qe e kam folur në analizën e tre mujorit të tretë po me dalin rezultatet tani, për dikun ka qenë ngarkesë për dikun pa pjekuri, ose edhe shitje mendje madhësie, por të gjitha këto që po i flas kanë dalë se i kam përmendur atëherë spo dua ti përmend edhe një here edhe rrezikun e grandeve dhe të hyrave të tjera, dhe shpenzimeve kapitale dhe të thjerra. Kam dy çështje të cilat janë brenda materialit. Së pari po shihet se kemi për çështje që perseriti ose drejtë për se drejtë u folen nga zyrtari kryesor financiar e kemi humbur grandin e performances jo vetëm për shkak të performances të 20% të huamarrjes po na kanë dhënë vjet për 2018 165 mijë euro nuk i kemi shpenzu kështu që është një mesazh që janë bartur por nuk janë shpenzuar kemi të pa shpenzuara 218 mijë të 2017 që ka qenë 2016 e turje e tutje. Këtë ne planifikime buxhetore duhet me e pasur parasysh mos të shkojnë projekte të cilat janë të pa realizuara se prap sivjet nuk do të ketë rishikim të buxhetit nuk kemi pasur 2 vite rishikim të buxhetit e jemi të vetëdijshëm që jon këto një prej arsyeve po dhëm kur 251 mijë euro shpenzime kapitale apo 11,7% kanë shkuar në suficit, u tha pse nuk dua të bëj pyetje, pa mundësia me i menaxhua. E kam parë që kemi shumë shpenzime të përmbartimit respektivisht janë të dhëna si shpenzime gjyqësore një shifër prej 44 mijë euro a ka të bëjë me borxhe të vitit 2018 të bartura në vitin 2019 edhe mua po me duket që është dyfishuar a mos po shkojmë duke hyrë në një rreth dificioz që i kemi një 59 mije euro borxhe të deklaruara është këto a mos po na ngrehin edhe me shumë 44 mijë euro e di që nuk lejon ligji ndrysh por 44 mijë euro

është një projekt i mirë, me ju shku përmbauesve është pak gjynah tjetër të detyrimet kontingjente të ato vendimet gjyqësore të specifikuara në material nga të hyrat financiare e një pozicione 185mije euro që e ka përafërsisht 2/3 apo më shumë se 2/3 e detyrimeve kontingjente, kisha dashur me e marr një përgjigje se për çka është fjala, dhe cilat janë implikimet reale të detyrimeve kontingjente një vendim gjyqësor për 185 mijë euro spo dua ta specifikoj kush e qyshe se tek fundi i fundit nuk është me rëndësi edhe një konstatim përfundimtar që prej atyre që tha 89 mije 89% faktikisht që e konstatoj edhe përmbushjen e planit hiq pagat kjo del rreth 79,5% . Besoj që dhe frigona që ky 20 % që respektivisht ky projekti skema e furnizimit apo huamarrja tema e furnizimit me ujë që shfrytëzohet vetëm 20%ka me na nxjerr telashe në vazhdimësi nëse jo tjetër kund të grandit i performances unë besoj që gjatë këtij viti edhe pse janë këto kusht pandemie është duke u punuar diçka edhe kisha sugjeruar Kryesues që në një mbledhje të ardhshme nuk kemi hapsir të na raportohet si ka shkuar dhe ku kan shkuar se janë në pyetje 5 milionë po na pengojnë ne hapin.

Kryetari i Komunës - e di që ajo kontratë është deri në mars të vitit të ardhshëm e di që ende janë duke prurë gypa mbi 200 shlipera gypa janë edhe atje po vonohen me u prodhu, ka vonesa së pari është menaxhimi i brendshëm është njëshi është puna e projektuesve, projektet jo kualitative me dilema e konkurrenca jo e nderhme në treg pastaj ankesa pas ankesave edhe shumë projekte janë shtyrë më marrëveshje të nenshkruara që kanë qenë krejt të prej 17 edhe 18 ka edhe sivjet projekte që kanë me u fillu ,ka që kanë filluar në fillim të vitit të kaluar dhe ka që nuk kane filluar ende.

Osmon Sadikaj - janë pyetje që kane nevojë përgjigje për opinionin, pyetjet janë te ndishme është përmbauesit dy pozicione janë nga përmbauesi privat dhe nga gjykata, po mu më bëri pershtypje me e bë një sqarim pse me shku paret te përmbauesi për ata e morra fjalën jo, nuk shkojnë paret te përmbauesi por përmbauesi i merr paret të na e ja dërgon operatorit ekonomik. Përmbauesi e merr përqindjen e vete edhe e rrit vlerën ose koston e komunës në shpenzime, por përmbauesi imerr ato që cilat i fiton kontestin është neni 39 pika 2 që shkojnë direkt nga ministria e financave pa gjykatë nëse operatori ekonomik i ka komplet në rregull dokumentet ka bërë kërkesë në komunë dhe nuk i ka paguar, dhe është tjetra përmes gjykate ku janë marr 44 mijë euro, kontingjenti që është në pasqyrë financiare. Rregulla e raportimit financiar thotë të gjitha paditë e kanë ber komunën për një kompensim financiar pa marr parasysh a e fiton kontestin a jo ato duhet duhet të pasqyrohen në pasqyra financiare.

Eliot Kukiqi - deshta të pyes për këto detyrimet kontingjente që i fitojmë a mund ti marrim këto mjete.

Osmon Sadikaj - Eliot ato janë imagjinare ligji të thotë përgatitu se kur të hupsh kontestin ku donë me ti marre, detyrimet kontingjente janë padi që janë në gjykata.

Agron Avdijaj - nëse kjo qeshje është diskutuar me herët, kurë është qeshja të përmbaruesi, përmbaruesi bazë e merr kontratën kolektive ndersa komuna nuk mundet mbi kontratën kolektive më i shpërnda këto mjete po me doket i nivelit të njëjte. Veç deshta edhe një sqarim kjo vlera që është 5 milion e diçka me cilën datë është nda, sepse në raportin e kësaj, performances për komunat, nuk është që kjo ka ndiku përqindja e këtyre projekteve kapitale ato është 73-4% nëse e ka arrit atë me u kualifiku 75 e nuk është për 67 si është këtu po me intereson kur ka figuru ky huaja 5 milionë data maji për afërsisht, a është në këtë vit a në vitin e kaluar.

Osmon Sadikaj - ndarja buxhetore është krejt diçka tjetër e huanë në vitin fiskal 2019 na kanë shti si ndarje buxhetore po e shihni alokimi ka qenë 1 milion e diçka mijë euro këta nuk e kanë marrë këta ndarjen në 75 po e kanë marrë alokimin.

Arif Elshani - ne dëgjuam shumë shifra edhe qeshje që me të vërtet komunën në qeshjen financiare e dëmtojnë, mendoj se qeshja e përmbaruesve dhe gjykatës është spo them keq menaxhimi i financave por mos menaxhimi i mirë nga drejtoret, ne shumica këtu e dimë që çdo landë që shkon ne gjykata ka koston deri në 20% mirë kish qenë që në te ardhmen komuna jonë që një lëndë mos ta dërgoni atje, nëse janë operatorët ekonomik mundeni që të bëni marrëveshje me ta dhe të mos vihet deri aty, mendimi im është që menagjimi me i mirë mundet mos me shku të përmbaruesi se nuk janë ato vlera të mëdha 44mijë e 7 mijë mund të vimi të vlerat me të mëdha që ta prish menagjimin e kapitalit edhe shërbimeve.e di shumë komuna që ka ë ardhur deri aty dhe kanë humbur kontrollin, ideja ime është që te kontrollohen më mirë punët kur ti kish borxh njërit edhe mos mujsh me ja pagu të ulesh me ta e të mos vish në këtë gjendje.

Arben Kabashi - megjithëse u sqaruan shumë pyetje u dhanë shumë përgjigje, zyrtari e tha dikund që mbi 395 mijë euro në një far forme i kemi pasur të planifikuara nëpër projekte a ka të bëj kjo të performanca që e kanë lyp komuna që unë nuk dua me u bazuar fort aty ka të bëj që ju kanë zgjatur kontratat për mos kryerje të punëve me afat kohorë por këto 395mijë euro kanë humbur.

Kryetari i Komunës - nëse i merre dhe i krahason komunat tjera po flas në bazë të takimeve që i kemi kryetaret e komunave brenda stacionit ka kanë qenë edhe ministri i financave, dhe i thesarit. Istogu është bindshëm me mirë se sa komunat tjera, kjo është e vërteta, këto janë publike janë shumë të qarta, nuk jam duke e thënë që jemi mirë po krahasime nuk po dua të bëjë. Ka komunë që i ka 6 milionë, ka komunë që tri vjet nuk ka mundur me u pastru edhe investimet kapitale gati 0 i ka pasë duke paguar borxhe. Kemi plotë raste.

Kryesuesi, pasi që nuk kemi diskutime tjera hedhe në votim këtë pikë të rendit të ditës

**Kuvendi unanim miratoi Raportin financiar për vitin 2019,
Në procedurën e votimit ishin 23 anëtarët e KK.**

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi, vazhdon me pikën e pestë: Shqyrtimi i Raportit Financiar për tre mujorin e parë të vitit 2020, fjalën ja kaloi z. Osmaon Sadikaj.

Osmon Sadikaj, ZKF - përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezentin dhe sqarimin e Raportit Financiar për tre mujorin e parë të vitit 2020,

Labinot Alijaj - Labinot Alijaj - vetëm dua ta përshëndes dhe ta falënderon për krejt punën që po e bën si për raportin që po na sjellë si për përshkrimet dhe analizën këtu që po e bënë, kështu që është mirë dikush me falenderu për punën që po e bënë faleminderit.

Naim Imeraj - faleminderit Osmon jo vetëm sot por gjithmonë ke qene në nivel të detyrës kësaj here i ki mshf kapak po nuk ka pas dem prej asaj pune kush ka dashtë i ka perpunu. Sa i përket raportit tremujorë me brengos qështja që raporti tre mujorsh ka qenë raporti para epidemisë e ka kapë marsin e raporti i dytë do të jetë problematik shifrat e të hyrave vetanake kategoritë shtylla që e mbajnë këtë buxhete janë bukur modeste edhe tatimi në pronë edhe lejet e ndërtimit qka dallojnë faktikisht dallon vetëm shëndetësia se më participim ka punuar vetëm QKMF-ja edhe ndonjë pozicion tjetër 14.5% edhe mu po me del 14.8 kjo tjetra nëse e marrë ZKF ajo çka është dhëne si planifikim 365 mijë aty d.m.th nuk është kaluar 15% për me kompenzu këtë 15% e me rrezik që me qenë edhe me i vogël se 15% së periudha e dytë ishalla e gjejmë edhe si popullatë e gjejmë forcën edhe prej luhatjes tonë financiare që po na bën pandemia prej pa mundësisë që me pas të ardhura konstante e përgjysmuara prej krejt ato obligimet ata që kanë mundësinë nuk do të rezervohen që me i kry pse prape së prape janë mjetet tona që kanalizohen besoj që 95% nëse e mbërrimi do të jetë premi sa i përket shpenzimeve nuk kemi çka me fole me të vërtetë e tha edhe zyrtari kryesor financiar nese në raport me alokimin e jo me planifikimin janë bërë krahasimet atëhere, në raport me planifikimet na del që edhe ato janë dikund ka 15% të planifikume veq së janë modeste si përgjegjësi, si total i buxhetit.

Agton Avdijaj - sa i përket këtyre raporteve financiare me thënë të drejtën duhet me pranë personalisht nuk kam eksperiencën e duhur për me i hi qasjes me i gjet ato defektet edhe të pa vërtetat. Naimi ka përvojë ma shumë në këtë drejtim. Edhe shpesh pi ngrit do po me doket po i zbut pak se ka hapësirë edhe ne raportim edhe në shpenzim të buxhetit. Ndërsa Lab sa i përket falënderimeve dhe sigurisht duhet me na falënderu edhe te gjithë neve që jemi prezent këtu së është detyrë e jona, edhe e ZKF.

Osmon Sadikaj - Agron si kritikant si lëvdatat dojm me i qit përpara po Naimi nuk e tha në kontestin se këtu po mshefet diçka, absolut. Unë e kry punën time në bazë të ligjit.

Kryesuesi - pasi që diskutime tjera nuk ka Kaloj piken tjetër

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi, vazhdon me pikën e gjashtë të rendit të ditës: Marrja e vendimit për Bartjen e mjeteve financiare nga vitet 2018,2019 nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara në vitin 2020j,

Hysni Maxharraj - bënë prezentin dhe sqarimin e Bartjes se mjeteve financiare nga vitet 2018,2019 nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara në vitin 2020,

Labinot Alijaj - do te doja sqarim lidhur me projektin me kod 2078 të shtatorja Ibrahim Rugova, të varrezat në Istog unë e di, e mbaj mend që në vitin e kaluar kemi ndarë 90 mijë euro për këtë projekt dhe jo 120 mijë sa janë të paraqitura në tabelë, 30 mijë ishin për ndërtimin e sheshit të gjakut që tash nuk figuron në bartje kurse sa i përket planifikimeve të reja po shohë disa mjete që janë nda për disa projekte të reja vetëm deshta të ja kujtoj Kryetarit që gjate propozimeve që i kemi për projektet kapitale 2020 -2022 me patë premtu që projektet e reja do të këtë parasysh dhe do të ndikoj që nder projektet e para për vitin 2020 do të jetë rrjeti i kanalizimit në shushicë të ulet për lagjet "Jahaj, Ademaj, Nimanaj, Selmanaj dhe Alijaj" kështu unë do ta dëgjoj edhe kryetarin se qfar përgjigje do të me jep për këtë atëherë do të vendosi a do të mbështes a jo po nëse në rast se nuk parashikohen mjete për atë projekt atëherë do të votoj kundër kësaj.

Agron Avdijaj - me propozimin e Labit pajtona edhe unë të njëjtin qëndrim e majmi.

Kryetari i Komunës - Nëse të kam premtuar publikisht kam dëshire ta mbaj, por e di që te kam premtuar më ndryshe, kam premtuar se aj projekt do të hy në buxhet tash është buxhet për vitin 2021 kështu ka qenë mundeni me e shiku edhe procesverbalin është aty. E dyta se di unë për memorialin Ibrahim Rugova nuk është miratuar 90 por 120, edhe sheshi është hjek arsya që është hjek sheshi është që nuk kemi mundur me mrri ne nuk kemi mundur me mrri për shkak të rrugës se aty të sheshi i gjakut do të bëhet një rreth, kjo rruga është vonuar, tash fillojnë punimet atje edhe për këtë vit ka pak pare kështu që edhe dy tri vite ajo ska me mbërri atje hiq ajo ka qen ideja kurgjo tjetër ma shumë kam qen i pasionuar për atë projekt se ndoshta edhe këto dy tjerat, për shkak të një kontuniteti historik po të tregoj drejt. Pse po merret edhe një here ky vendim.po merret se është vonuar për shkak të procedurave se ajo ka pas me fillu vitin e kaluar, me sa di procedurat kanë qen të përfunduara tek

në dhjetor ka pasur ankesa në OSHP edhe hala nuk është zgjidhur, aj problem tash është vensosur dhe presim vendimin me fillu punimet.

Labinot Alijaj - sa i përket projektit në fshatin Shushicë e ulët, është thënë dhe kam procesverbalin bile e kam kërkuar gjate votimit të procesverbalit me ma ripërsërit, thotë që projektin e parë për vitin 2020 që do ta mbështes ose përmes grandeve ose përmes fondeve, tona që do ta përfundoj do të jetë projekti tër atë fshatë nëse sa i përket kësaj jam i bindur që nuk po them që është 100% që jon nda 90 mijë euro për shtatoren Ibrahim Rugova dhe 30 mijë përsheshin e gjakut. Është për skulpturën për kryetarin Fadil Feratin e ndjere ka qënë 20 mijë e kemi rrit ne 30 mijë ne mund ti shikojm janë peocesverbalet është gjendja po unë jam i bindur se këto janë kështu.

Hysni Maxharraj - në bartje kanë qënë ashtu 90 mije për shtatoren Ibrahim Rugova të memoriali, 30 mijë të sheshi i gjakut, ndërkohë me një ridestinin janë paraqir ofertat ka dal që oferta me e lirë është afer 120 mijë euro, do të thotë nuk kanë mjaftuar ato mjete dhe është paraqitur kërkesa me i shtu mjetet për shtatoren e Ibrahim Rugova. Për te sheshi i gjakut jemi zotu që menjëherë me e shti në projekt sheshin e gjakut, po tani ka ardhur qarkorja buxhetore 1 dhe jemi zotuar të gjithë se menjëher me e shti në buxhet atë projekt se kur të përfundon rruga me shti aty nuk e kemi hjek me e harru por me vendos për vitin e ardhshëm. Për kanalizim faktikisht këto shumica janë projekte të vitit kaluar janë disa projekte të domosdoshme qe menjëherë ne vitin e ardhshëm. Patjetër duhet të ketë sivjet rishikim sepse kjo pako emergjente fiskale që është aprovuar dhe që jemi duke punuar me të kjo nuk është e aprovuar në ligj të buxhetit, ligji i buxhetit është aprovuar para pakos emergjente do të thotë se cila qeveri është duhet në rishikim me e qit pakon emergjente edhe po besojmë që komuna duhet të shkojnë ne rishikim edhe po besoj që momentin e parë e qesim kanalizimin në Shushicë ose ose në planifikimin e buxhetit të ri qe ka ardh qarkorja 1 dy opsione të mundshme.

Agron Avdijaj - përveç se pajtona me propozimin e Labit unë qet far listën që e kam këtij projektet për bartje, ose nuk po e shoh mirë ose përmirësomani nëse nuk është ashtu, as një projekt nuk është i dedikuar për pjesën e mbivadës kjo për mua është shqetësuese nuk po dua me e trajtu kështu sepse zakonisht po përgjigjeni se nuk po i anashkaloni po konsideroj që është shqetësuese dhe për kete arsye une nuk mund të votoj për bartje e këtyre mjeteve.

Kryetari i Komunës - këtu ka mjete të bartura ti tash shiko buxhetin e tërësishmen ka mbivada a ska projekte.

Ajshe Metaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, u përmenden ato projekte shtatorja e Ibrahim Rugovës dhe pllaka e Fadil Feratit, edhe kemi pasur rastin e sheshit te gjakut që e kemi debatuar edhe me kryetarin që ka qënë një projekt i rëndësisë mjaft të madhe edhe që kom prit që mos me u shty ky projekt për vet faktin që janë gjëra që i lidh historia dhe është dashur që ju tash edhe me përpara me kontribu në këtë

drejtim mirë po si thonë populli ma mirë është pak vonë se sa hiq e kam një pyetje a ka pasur mjete të planifikuara për sheshin e gjakut. A ka qenë listën e projekteve.

Kryetari i Komunës - ka qenë vendimi i vitit të kaluar që ka qenë i përfshirë edhe sheshi nu e di a ka qën 30 apo 40 mijë.

Ajshe Metaj - d.m.th mu me vjen mirë që projektet e përgjysmuara duhet në fakt me u bë veq siç e dëgjova Kryetarin me erdh keq pse kjo me u shty për tri ose katër vjet. Propozoj që kjo sa me par të hy si projekt dhe të realizohet sepse është interes i të gjithë qytetarëve, është histori është gjake janë themelet e lirisë.

Arif Elshani - ne po flasim për projekte unë që 7 vite i lypi varrezat e Saradranit me i shti në projekt, mi kanë shti në listë me të kuqë mi kanë hjek edhe mendoj që ndoshta kit mandat qato varreza me jau qit një themel është kërkesa me e kry komuna këtë punë se ndoshta kish pas donator që atë e kishin kry sepse nuk është investim i madhë por bëje kërkesë publike që te parashihen qe komuna ti rrethoj ato varreza dhe tja bie një identitet se janë një nder varrezat me karakteristike ndoshta në komunë që meritojn me i rrethu. Ka njërez që i kishin rrethu ato varreza po aty ka qeshtje pronësorë ka mexha ka shumë probleme që nuk mundet as një donator apo ndonjë pricat më i realizu ato përveç Komuna. Kjo është kërkesë publike kësaj radhe nëse i shtini ndonjëherë me i hjek nga via e kuqë me i qit ne të katërtën.

Naim Imeraj - me rrezikun që po përsëritna por edhe vitin e kaluar kur kemi bere bartje të mjeteve besoj që mundet me u rikujtu apo mos me u rikujtu po është ne procesverbal e cila e arsyeton përmbajtjen tjetër të listës së bartjes së mjeteve kanë qenë këto 3 projekte që tani janë shndërruar në dy projekte shtatorja e Ibrahim Rugovës dhe punimi artistik pllaka e Fadil Feratit.

Nëse ka qene problematika e prokurimit atëherë është e arsyetueshme, por nëse ka qene me vonës fillimi e mjetet i kemi pasur në dispozicion për mu është prekesë, edhe me preke fjala paraprake e profesoreshës ke ka një here lidhet njeri në diçka që është emocionale që ka një vlerë të lartë edhe hjek dorë prej vërejtjeve të cilat i ka në pjesen tjetër janë këto mjete që janë më to munden veq me hjek dhe me qit dikund tjetër, nuk mundemi me kriju mjete tjera se janë këto që janë po unë po shpresoj që se paku nuk do të vim që në pozicion që në bartjen e mjeteve të vitit të ardhshëm, e po e mbaj për fjale kryetarin këto dy projekte shtatorja e Ibrahim Rugovës dhe pllaka e Fadil Feratit, nuk do të jen në listë si projekte të parealizuara në këtë logjikë se pavarësisht rrezikut se ndonjëherë edhe veten po e shoh me shumë si këshillues se sa kritikues. Spo dua të replikoj me Agronin e di është e vërtet aho që po e thotë Agroni po pervoja po e bën ka një here që më i dhënë prioritet gjanave më shumë se sa krimin e një elektrizimi. Kryetar a është konfirmimi që kjo procedurë është kryer edhe që do të vazhdoj këto dy projekte apo mbetemi prape në procedura të prokurimit.

Kryetari i Komunës - këto projekte faktikisht për qita po merret për herën e dytë vendimi të memoriali është kryer por nuk mund të vazhdojmë pa u marr vendimi final se ajo është vonuar edhe në at aspektin që po e përmend ti, edhe mos përvoja se nuk jemi marr me vepra artistike edhe kjo ka qenë një element nuk ka qen një konkurrencë kumeditë qfare edhe kjo ka ndodhur mirë po pastaj kryesi është vonuar për punën e ankesave së përndryshe s'do të kishim nevojë sikur ta kishim bere kontratën në kohen e duhur vitin e kaluar ne nuk ishim marr me këtë phnë ky është problemi, ndërsa kjo e Fadil Feratit nuk ka filluat kurgjo këtu unë besoj se menjëherë pas kësaj duhet ta fillojmë këto beso qe edhe kjo do të përfundoj këtë vit . Ndërsa sheshi i gjakut nuk do te përfundoj këtë vit për arsyet që ua thash me heret. Me sheshin ne të ghithve na lidhin shumë ngjarje aty, jam idhtat i ngjarjeve që kanë ndodhë me herët, këtu njerëzit për je shtet që e kemi sot kanë punuar.

Arben Kabashi - pyetje për projektet e reja me interesoje ne kemi dhënë shumë propozime me e votu KAB-in, sot përveç në emër të grupit të PDK të gjitha propozimet që kanë rrjedhë në komunën e Istogut masë meje nuk ka propozu dikush diçka ndonjë ide për ndonjë propozim të ri duke e përfshirë edhe trotuarin Gurtakoc-Tomoc, që ju kanë shtua 10 mijë euro, por deshta me dal të pyetja a janë këto projekte të reja propozime, të KAB-it a janë projekte të reja që i kemi 9400 mijë euro dikund ne vlerë që i shkojnë projekteve të reja po ashtu unë deshta pak një pyetje me ja bë se të kodi rregullativ, se po shtohen edhe 30 mijë euro të memoriali Ibrahim Rugova.

Hysni Maxharraj - Arben të ndërtimi i shtatores Ibrahim Rugova është kodi janë të paraparë 120 mijë euro nuk ka nevojë të shtohet asgje, në shkresen që shkon në thesar aty ne e sqarojmë. Trotuari Gurrakoc- Tumoc, komiteti e ka propozu.

Zenel Shatri - e kam thënë edhe atëherë dhe tani po e them nëse pare nuk ka për bursa të studentëve jam për bursa jo për projekt, nëse ka pare për bursa le të hin trotuari në projekt, që 3 a 4 vite jam duke e kërkuar është i nevojshëm.

Hysni Maxharraj - ne bazë te gjendjes që jemi dhe nuk kemi të hyra, drejtori i Arsimit ka. Kërkua që këto 10 mijë euro të alokohen për Arsim ne subvencione nëse nuk mundemi me i argetu të hyrat vetanake të këtij viti atëherë ti kemi në dispozicion ato 10 mijë euro.

Naim Behlulaj - përsëendetje për te gjithë të pranishmit, në lagjen Myrtaj janë 160 m rruga e pa asfaltuar. Është rruga e pa kalueshme kërkoj që ta asfaltoni edhe atë rrugë. Të hy në projekt.

Agron Avdiqaj - u konstatua që këtë vit do te kemi problem edhe me të hyra vetanake, u konstatua që duhet me hjek dorë edhe nga disa projekte, pa dashur të keqkuptohem nga të tjerët, po besoj që edhe Ibrahim.Rugova edhe Fadil Ferati të Ishin gjalla kishin thanë shtyni këto projekte ashtu kështu e keni shty memorialin

Ibrahim Rugova edhe është një shumë e konsiderueshme që po besoj që kishim mund me i shty. Mos e merrni këtë që unë jam kundër këtyre se vet i kam votuar mirë po besoj që edhe opinionin publik i ka kërkuar këto dy projekte për shkak të vlerave të tyre që kanë, por po besoj që të ishin ata në situata të cilat jemi ne kishin me propozuar vet ata që të shtyhen këto.

Labinot Alijaj - po du një sqarim , projekti me kodin që nuk po ja di sheshi i gjakut, aj projekt po anulohet prej sodit nuk po ekzistoni më pasi që nuk po planifikohet për dikur tjetër aj po anulohet këto 30 mijë euro po parashihen me u planifikuar të kodi 42078 shtatorja Ibrahim Rugova tek memoriali, prej 90 mive u bë 120 mijë po mendoj që prape ne mundemi me 90 mijë me kry se atëherë kur e kanë parapar eksperta kan qen edhe ata kam mëndu që me 90 mijë euro kryhet e këto 30 mijë euro me i dergu në rrjetin e kanalizimit aty ku me premtuat tanë, kjo po i bjen që operatorët që po konkurojnë ne po na rritin çmimet ti duhet me qit 90 mijë ti me 90 mijë let konkuronë. Jo aj me ta rrit çmimin ty me shku tuj shtu paret.

Kryetari i Komunës - kogja jam i bindur që nuk ka me shku as një e di që ka me pas me pak të hyra vetanak, te të hyrat vetanake i ki 1 milion euro nuk na bëjnë ndonjë dem të madhë.

Labinot Alijaj - propozon që 90 mijë euro të mbesin për shtatoren e presidentit Ibrahim Rugova dhe 30 mijë euro le të shkojnë për kanalizimin në fshatin Shushice e Ulet.

Naim Imeraj - besoj që ish dashur me i taku drejtorit të drejtoris përkatëse me i sqaruar se kjo listë i ka 474,781.58 euro po mundet mos me pas as një projekt si start e ka as një projekt. Nëse kjo ish dasht me vazhdu edhe më i kqyr apetiteti ndoshta me del edhe mu një apetit edhe e barazojmë mos të merr askush si personale krejt ata që kanë thënë krejt janë të arsyeshme po në start thash kemi aq sa kemi pare edhe krejt këto projekte munden të jen krejt tjera, ne jemi ata që e bëjm bartjen e mjeteve edhe mundemi me qenë, mos të harrojm se 250mijë euro te shpenzimet kapitale na kanë shku në suficit këto tjerat ka projekte. Vlersimi paraprak i drejtorëve te drejtorive i kryetarit, kanë qen këto prioritete nese në vazhdojmë me bë kërkesa kam dilem se cili tash prej propozimevë e ka një arsyeshmeri më të madhe dhe tash nermal qe me duhet me e përkrah Naimin, ju lus që te jeni me të arsyeshëm nëse i keni dy kërkesa me u ndrru kjo struktur kjo pikë këtu ma ska vend se po na qitni në lajthitje me u ndal unë mos me propozuar dhe mos me miratuar hiq.

Labinot Alijaj - qite ne votim propozimin tim.

Arben Kabashi - faji është te të gjitha partitë politike nuk dua ta fajësoj veç e veç as një për shkak se nuk mbajnë mbledhje anëtarët e asamblesë me njerëzit që i kanë në KPF përderi sa një parti politike i bjen një vendim dhe thotë kit propozim vendim

për kete projekt të mujshim.me shti në ketë bartje që me mujt me kalu atëherë kjo kalon edhe përmes komiteti për politik e financa dhe vjen në asamble.

Ne i kemi 120 mijë euro në memorialin Ibrahim Rugova si dum me e bë ketë shkëputje 30 mijë euro kur me letra zyrtarë ne i kemi 120 mijë euro. Pajtona me ty Lab, por nuk po e di si mund të ja ndajmë projektit 30 mijë euro kurë ne mbledhjen paraprake kemi vendos për ato mjete.

Kryesuesi - ky është realiteti qe e tha edhe Arbeni.

Labinot Alijaj - sqarojeni me mirë ketë një here ka qenë 90 mijë për shtatoren tani është bere në 120 mijë.

Kryetari i Komunës - let del në votim ky propozim.

Kryesuesi hedh në votim propozimin e Labinotit, qe 120 mijë euro për shtatoren e Ibrahim Rugovës, ti hiqen 30 mijë dhe të shkojnë në kanalizimin në Shushic e Ulët. kush është për 5 kundër 10 abstenime 8

23 anëtar te KK prezent

Hedh në miratim bartje,

Miratohem me 14 për 3 kundër 6 abstenime.

Shqyrtimi i pikës 7

Kryesuesi, vazhdon me pikën e shtatë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Nismës së Kryetaret të Komunës për bashkëpunimit nderkomunal me komunë e Pejës ,

Kryetari i Komunës bën prezantimin dhe sqarimin e Nismës së Kryetaret të Komunës për bashkëpunimit nderkomunal me komunë e Pejës ,

Naim Imeraj - sa është vlere e projektit me të cilën konkurron Peja.

Kryetari i Komunës - nuk e di sakte se sa hektar tok ka në komunën tonë por pjesa me e madhe është në komunën e Pejës. Shuma nuk e di saktë sa është.

Kuvendi me votim unanim miraton Nismës së Kryetaret të Komunës për bashkëpunimit nderkomunal me komunë e Pejës
Në procedurën e votimit ishin 23 anëtar të KK prezent.

Shqyrtimi i pikës 8

Kryesuesi, po vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës: Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal. është mirë që këtë pikë ta bëni me shkresë ekzekutivit që të jen me të përgatitur

Valbona Demaj - pyete, pas shkollës Haxhi Zeka gjimnazit ne Istog shëtitorja që është , gjate lumit kam kërkesë nga qytetaret të behet spërkatja kundër gjarpërinjve, dhe të behet pastrimi i lumit.

Agron Avdijaj - pyete, lidhur me fermerët për shkak te arave që kanë, u pat thënë me u këqyr mundësia me u përkrah nga niveli qendror nuk e di a ka mundur me pas hiq kontakt dhe si është procesi e di që tash Ministri e ka ber një grup punues për vlerësimin e dëmeve, por nuk po e di ku është procesi, a ka pas ndonjë bised konkrete me nivelin qendrore lidhur me këtë.


Kryesuesi - e ke fjalën për demet e erës a po, ne në këtë kuvend u jemi drejtuar Qeveris së Republikës së Kosovës për ndihmë, kërkesa në emër të kuvendit është dërguar por nuk kemi marr përgjigje.

Kryetari i Komunës - me ministrinë e bujqësisë kam dalur edhe në teren dhe kemi bere vlerësimet vet, ministria e arsimor ka nda mjetet lër shkolla. Në bujqësi ndodhi epidemia dhe mbetem kështu ende nuk është marr diçka.

Kryesuesi -- faleminderit për kontributin tuaj.

Mbledhja përfundoi me punë në orën 13.10.

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj



Kryesuesi i Kuvendit,
Clash Balaj

